



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE**

**V E N D I M**

**Nr. 443, datë 26.06.2019**

**PËR  
“ORGANIZIMIN E PROCESIT MËSIMOR DHE PËRZGJEDHJEN E  
ARSIMTARËVE NË DIASPORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4 të nenit 10 të ligjit nr. 16/2018, datë 05.04.2018 “Për diasporën”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave,

**V E N D O S I:**

1. Objekti i këtij vendimi është të nxisë dhe të përkrahë organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në vendet pritëse të diasporës shqiptare. Procesi mësimor në vendet pritëse të diasporës shqiptare është mësimi i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare.
2. Procesi mësimor dhe përzgjedhja e arsimtarëve në diasporë mbështetet nga ministria përgjegjëse për arsimin në zbatim të marrëveshjeve dypalëshe shtetërore dhe në përputhje me legjislacionin e vendit pritës të diasporës shqiptare. Ky proces realizohet në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për diasporën dhe ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.
3. Kanë të drejtë të ndjekin mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në vendet pritëse të diasporës shqiptare:
  - a) fëmijët e moshës deri në 18 vjeç me kombësi shqiptare.
  - b) çdo person me origjinë shqiptare që jeton në vendin pritës, pavarësisht statusit të tij, me qëndrim të përkohshëm apo të përhershëm, azilkërkues, të strehuar të përkohshëm apo persona pa shtetësi.
4. Mësimi zhvillohet në përputhje me kurrikulën e përbashkët të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, sipas marrëveshjes midis ministrisë së arsimit dhe sportit të Republikës së Shqipërisë, ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë si dhe ministrisë së diasporës të Republikës së Kosovës “Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatës” datë 23.3.2015”, ose sipas



programeve dhe planeve të miratuara nga ministrinë përgjegjëse për arsimin në vendet pritëse.

5. Ministrinë përgjegjëse të arsimit të Republikës së Shqipërisë dhe të Kosovës bashkëpunojnë për hartimin e dokumenteve të përbashkëta për organizimin e procesit mësimor, duke parashikuar mënyrën e formimit të grupeve të nxënësve, rezultatet e të nxënësve sipas niveleve, tematikat dhe temat mësimore orientuese, planin mësimor, kohëzgjatjen e orëve mësimore, mënyrën e vlerësimit të nxënësve dhe aspekte të tjera që kanë të bëjnë me fushën e të nxënësve.
6. Ministria përgjegjëse për diasporën, nëpërmjet Qendrës së Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, mbështet dhe inkurajon procesin mësimor të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë me tekste shkollore, materiale plotësuese dhe zhvillim profesional të mësuesve.
7. Kërkesa për tekste shkollore, materiale plotësuese dhe sasia e tyre mblidhet nga përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë në vendet pritëse të diasporës shqiptare. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme i dërgon këto kërkesa, të përcaktuara sipas vendeve dhe grupmoshave të fëmijëve, brenda muajit maj të çdo viti në Qendrën e Botimeve për Diasporën, ministrinë të Shtetit për Diasporën dhe për dijeni ministrinë përgjegjëse për arsimin. Qendra e Botimeve për Diasporën dërgon në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme sasinë e teksteve dhe materialeve plotësuese, brenda muajit gusht të çdo viti, për t'i shpërndarë sipas kërkesave në vendet pritëse të diasporës shqiptare.
8. Qendra e Botimeve të Diasporës pranon kërkesa për tectë shkollore edhe nga mësuesit që janë bërë pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, konfirmuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin. Qendra e Botimeve të Diasporës lidh me këta mësues kontrata të furnizimit me tekste shkollore për fëmijët në diasporë.
9. Qendra e Botimeve të Diasporës përgatit informacion vjetor për sasinë dhe mënyrën e shpërndarjes së teksteve shkollore në diasporën shqiptare, të cilin e dërgon pranë ministrive përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme.
10. Pikat 6.5 dhe 6.6 të Vendimit nr.107, datë 10.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, shfuqizohen.
11. Deri në miratimin e teksteve të përbashkëta për arsimin në diasporë nga Komisioni i Përbashkët në zbatim të Marrëveshjes “Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, datë 23.03.2015, nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe nga Ministria e Diasporës së



Republikës së Kosovës, kërkesat për tekste shkollore, materiale plotësuese dhe sasia e tyre në përputhje me pikën 7 të këtij vendimi do të dërgohen drejtpërdrejtë pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën, e cila ngarkohet me sigurimin dhe shpërndarjen e tyre brenda muajit shtator.

12. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministri i Shtetit për Diasporën, Qendra e Botimeve të Diasporës dhe Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E M I N I S T R I**  
**ED I R A M A**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

**MINISTRI I SH T E T I T**

**PËR DIASPORËN**  
**PANDELI MAJKO**

**MINISTRI I ARSIMIT,**  
**SPORTIT DHE RINISË**  
**BESA SHAHINI**